

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.17 Regj. Themeltar, Datë 06.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia e Lirisë.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - (KQZ).

Objekti: Ndryshimin e vendimit nr.71, datë 02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:
Caktimin e Partia e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Më datë **08.05.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Blerona Hasa (Anëtare);**

Me Urdhër datë 08.05.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **09.05.2023, ora 13:30**, për zhvillimin e seancës gjyqësore në: **ambientet e godinës “Poli i Drejtësisë”, salla e konferencave të KLGJ-së, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Tiranë.**

Tiranë, më 08.05.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë